# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-423728**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shërbime konsullore kudo dhe në çdo kohë, ngrihet Prania Diplomatike Virtuale, Hoxha: Shteti shkon pranë qytetarit! – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/sherbime-konsullore-kudo-dhe-ne-cdo-kohe-ngrihet-prania-diplomatike-virtuale-hoxha-shteti-shkon-prane-qytetarit/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:14:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 30 gusht 2026, 12:05:48 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0ab4168f159df255b5bed28d2759c10e201033d1d504d7ef42806eeabc576ee0` |
| TEKSTI | `c78c7c82e4e7fb4c3fbd4190ec608ee9e81fc9cc186c08eeeef4b93142725478` |
| PAMJA | `26143854dd7cfa233de4aa1df8c6d2911d96ab77d6588209bf35d8491240871f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `297fcc68cfc25a2480cad03a40b06ca129c264ebe0a5045c71ffa3711f13d4db` |
| E MËPARSHMJA | `b399418d70eb46118d0daddda1ec1b7ddec3bd5e8251da22711766511a996232` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/297fcc68cfc25a2480cad03a40b06ca129c264ebe0a5045c71ffa3711f13d4db`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

hyjnë në një fazë të re dixhitale. Lajmin e konfirmoi këtë të diele Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, duke njoftuar se shumë shpejt do të krijohet Prania Diplomatike Virtuale, një pikë e vetme digjitale për informacion dhe shërbime konsullore edhe në vendet ku Shqipëria nuk ka përfaqësim diplomatik fizik.

Përmes një video-mesazhi të publikuar në rrjetet sociale, Hoxha e cilësoi shërbimin konsullor si një histori suksesi, që sipas tij lidhet jo vetëm me transformimin teknologjik, por edhe me përmirësimin e mënyrës, cilësisë dhe shpejtësisë së ofrimit të shërbimeve.

Sipas ministrit, gjatë periudhës 2017-2026 janë administruar 1 milionë e 378 mijë shërbime konsullore. Ai bëri të ditur gjithashtu se nga viti 2019 deri në qershor 2026 janë administruar 4 milionë e 300 mijë legalizime, ndërsa që prej vitit 2021 janë regjistruar mbi 203 mijë aplikime për e-Visa

Hoxha tha se angazhimi i Ministrisë është të thjeshtojë më tej procedurat dhe ta afrojë shërbimin sa më shumë me qytetarin.

*"Konkretisht, po punojmë për realizimin e një Asistenti Virtual, i cili, nuk do të ketë orar, përgjigjet në çdo kohë e për çdo pyetje dhe kudo, dhe të orientojë kërkuesit drejt shërbimit. Në çdo shërbim konsullor do të vendoset një QR Code për të vlerësuar shërbimin dhe për çdo ankesë të mundshme. Qytetari të mos jetë jetë vetëm përfitues i shërbimit, por edhe vlerësues i tij. Me një fjalë, duam të dimë si po punojmë dhe si të përmirësojmë", tha Hoxha.*

Ai njoftoi gjithashtu krijimin e Pranisë Diplomatike Virtuale, e cila do të


5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit



NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

shërbejë si një pikë e vetme digjitale për informacion dhe shërbime konsullore për qytetarët që ndodhen në vende ku Shqipëria nuk ka përfaqësi diplomatike.

"Duam të kalojmë nga praktika kur qytetari shkon te shteti, te ajo ku shteti shkon dhe është gjithnjë pranë qytetarit", tha Hoxha.

Ndërkohë, drejtoresha e Çështjeve Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Irida Laçi, bëri të ditur se aktualisht ofrohen online 32 shërbime konsullore. Sipas saj, 22 prej tyre nuk kërkojnë detyrimisht praninë fizike të qytetarit dhe, aty ku natyra e shërbimit e lejon, dokumentet mund të dërgohen edhe me postë.

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku · 3 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku · 10 minuta më parë



EKONOMI

**Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër,...**

Xhuljana Zhuleku · 38 minuta më parë



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.